

VENDIM
Nr. 69/2013

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN E
TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e deputetit Taulant Balla,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet për shërbimin e transportit përcaktohet sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Përfitimi financiar mujor për shërbimin e transportit të mos i nënshtrohet tatimit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 18.12.2013.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 28.12.2013

Lidhja nr. 1

**MASA E PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN
E TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

Nr.	Qarku	Vlera mujore (në lekë)
1	Tiranë	30 016
2	Durrës	31 214
3	Lezhë	34 035
4	Elbasan	33 702
5	Dibër	40 000
6	Vlorë	40 000
7	Shkodër	40 000
8	Fier	40 000
9	Berat	40 000
10	Kukës	40 000
11	Korçë	40 000
12	Gjirokastër	40 000